



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS - SHTIME
Komiteti për Politikë dhe financa
Nr.01-060/01-9922/23 datë: 19.04.2023



Npi – 01/181 datë: 25.04.2023

Duke u bazuar në nenin 49 dhe 52 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040; Si dhe në bazë të nenit 3.13 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve, Npi-01/114 të datës: 26.04.2019, Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e mbajtur më: 25.04.2023 nxjerr këtë:

E K S T R A K T
PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË -IV- TË KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA
E mbajtur më datën: 25.04.2023 (e martë) në ora 09:00 h. në sallën e vogël të Kuvendit

Në mbledhje kanë marrë pjesë: Kryesuesi i KPF-së z.Adnan Ademi, Anëtarët e Komitetit: z.Përparim Ramusa, z.Lumni Amrush, znj.Adelina Beqaj, znj.Saniye Sadiki, dhe z.Kadri Emini. Përveç anëtarëve të KPF-së në mbledhje ka marrë pjesë edhe: z.Grejtalb Emini drejtor i DPUKGJ, z.Kastriot Shabani drejtor i DZHE, dhe z.Bardhyl Rushiti drejtor i DSHP, z.Bujar Ferati, Zyrtar Kryesor Financiar, z.Reshat Gashi, zyrtar për të drejtat e njeriut dhe barazi gjinore. Mbledhjen e hapi, Kryesuesi i KPF-së z.Adnan Ademi, i cili pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, konstatoi Kuorumin e mjaftueshëm për mbajtjen e mbledhjes. Për këtë mbledhje kemi propozuar këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi i Ekstrakt-Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 28.03.2023,
2. Propozim-Vendim për zgjedhjen e Komisionit për organizimin e zgjedhjeve për fshatra dhe lagje urbane në Komunën e Shtimes,
3. Shqyrtimi i Raportit financiar të komunës së Shtimes për periudhën Janar-Mars 2023,
4. Bartja e buxhetit të pa shpenzuar nga viti i kaluar në vitin aktual, dhe rritja e kufirit të hyrave,
5. Draft-Strategjia dhe Plani i veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje 2023-2025, (Pas diskutimit publik).
6. Draft- Rregullore për punën e Kuvendit dhe Komiteteve, (Pas diskutimit publik)
7. Draft-Plani Komunal për integritet 2023-2027, (Pas diskutimit publik)
8. Plani Komunal për Ri integrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe Integrimin e të huajve, në Komunën e Shtimes 2023-2025,
9. Rishqyrtimi i Vendimit Npi-01-81, për Planin komunal për menaxhimin e Mbeturinave 2023-2027, sipas kërkesës të MMPH1-ja Nr.020-282-5-2023,
10. Propozim-vendim për ndryshimin e destinimit të pronës së paluajtshme komunale në N.K. P-01895-4 ZK-Shtime,
11. Propozim -Vendim për pagesën e shpenzimeve të varrimit për qytetarët që varrosen në territorin e Komunës së Shtimes,

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për rendin e ditës.

z.Përparim Ramusa; Përshëndetje, në parim pajtohem me rendin e ditës, përveq që pika e dytë dhe e katërt të shkojë direkt në Kuvend, sepse i kemi konsumuar këto pika dhe i kemi dhënë rekomandimet.

z.Kadri Emini; Përshëndetje, e kemi një propozim nga Përparimi. Edhe unë e përrahi këtë propozim të Përparimit.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Pajtohem me propozimin e Përparimit.
* Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht miratoi rendin e ditës.

Pika 1

Shqyrtimi i Ekstrakt-Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 28.03.2023

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

*Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht miratoi, Ekstrakt-Procesverbalin nga mbledhja e KPF-së, e mbajtur më 28.03.2023.

Pika 2

Propozim-Vendim për zgjedhjen e Komisionit për organizimin e zgjedhjeve për fshatra dhe lagje urbane në Komunën e Shtimes

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Ashtu qysh vendosem në fillim me miratimin e rendit të ditës kjo pikë shkon direkt në Kuvend si rekomandim, sepse është konsumuar diskutimi për këtë pikë.

*Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht vendosi t'i Rekomandoi Kuvendit, miratimin e vendimit për zgjedhjen e Komisionit për organizimin e zgjedhjeve për këshillat e fshatrave sipas këtij qelësi:

- Nga Kuvendi të zgjidhen 4 anëtarë,
- Nga Shoqëria Civile të vjen propozimi në Kuvend dhe të votohet përbërja komplet,
- Përfaqësuesi nga Ekzekutivi të vjen nga Administrata me një kandidat jo politik (pa pozita politike),
- Të plotësohet kuota gjinore,
- Përfaqësuesi i fshatit ose lagjes urbane, zgjidhet aty për aty në mbledhje.

Pika 3

Shqyrtimi i Raportit financiar të komunës së Shtimes për periudhën Janar-Mars 2023

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha z.Bujar Feratit.

z.Bujar Ferati, Zyrtar Kryesor Financiar; Përshëndetje, materialin e keni marrë me kohë, në fillim sqaroi bazën ligjore sipas LVL-së për obligimin që kemi për raportim para Kuvendit. Në vazhdim lexoj Raportin në pikat kryesore me shumat financiare. Nëse ka ndonjë pyetje unë do të përgjigjem.

z.Përparim Ramusa; Kam një pyetje, pse nuk është votuar në buxhet kolektori ose huamarrja?

z.Bujar Ferati, Zyrtar Kryesor Financiar; Është thënë se huamarrja do të mbyllet në vitin 2022. Për momentin nuk kemi informacion a duhet vendim i Kuvendit apo jo i cili shkon në Qeveri. Informacioni i fundit është që mbyllet huamarrja në vitin 2022 nga departamenti i Ministris së Financave.

z.Lumni Amrushi; Nëse aprovohet vendimi a ka mundësi që mjetet të shpenzohen apo vetëm barten, apo ndoshta ka edhe telashe të tjera?

z.Kastriot Shabani, drejtor i DZHE; Tash është nënshkruar edhe menaxheri i kontratës dhe deri në Qershor unë nuk e shoh problem hargjimin e mjeteve, nëse kalon vendimi në Qeveri.

z.Kadri Emini; Nëse 296 mijë euro ndalen a jemi në gjendje ne si Komunë që ti paguajmë?

z.Bujar Ferati, Zyrtar Kryesor Financiar; Dha sqarim.

z.Përparim Ramusa; Kam qenë pjesë e Kuvendit kur është votuar kjo kredi. Dhe pas një viti në qeverisjen Haradinaj, Kryetari ka arritë që këtë barrë me marrë Qeveria e Kosovës. Kështu që Komuna nuk ka asnjë obligim financiarë. Me punimet që po bëhen nuk jam i kënaqur, ky, ky është shqetësimi jonë. Bujari tha se kredia Bujari tha se kredia është mbyllur në vitin 2022. E dimë për dy vite kohën e pandemisë Kovid19. Grejs periudha për pagesë ka qenë me filluar pas 5 viteve.

z.Bujar Ferati, Zyrtar Kryesor Financiar; Në mbledhjen e Kuvendit kam me ju pru material dhe informata më të detajuara për projektin e kolektorit.

z.Lumni Amrushi; 12 mijë euro për ndarjen e Subvencioneve, pyetja për Drejtorin për me e sqaruar pak për çka janë shpenzuar?

z.Kastriot Shabani, drejtor i DZHE; Përgjigje, me OJQ "Help" dhe "Mushtjerra" janë shpërndarë.

z.Bujar Ferati, Zyrtar Kryesor Financiar; 7,800 euro për nënat lehona.

znj.Adelina Beqaj; Përshëndetje, a ka informacion për të hyart vetanake që po thuhet se po shkojnë në Qeverinë e Kosovës.

z.Bujar Ferati, Zyrtar Kryesor Financiar; Në Kuvendin tonë kemi marrë vendim për bartjen e mjeteve për vitin 2022 dhe 2021, që i kemi 350,000 € dhe ne kemi bërë kërkesë për të na i bartur të gjitha mjetet dhe po presim përgjigje. Në Kuvendin Komunal e bijë shumë e saktë sa janë të vitit 2021 dhe sa të vitit 2022. Shtyrja e mosaprovimit e shtynë edhe shtyrjen e ekzekutimit të shpenzimit të këtyre mjeteve. Egziston edhe rreziku që ti humbim krejt.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Konstatoi Kuorumin prej 6 anëtarëve prezent në mbledhje.

***Komiteti për Politikë dhe Financa, me 3 vota “Për”, me 3 vota “Kundër” dhe me 0 vota “Abstenim” (duke përdorur të drejtën e votës së dyfishtë “Për” të Kryesuesit) me 4 vota “Për” vendosi t’i Rekomandoi Kuvendit, miratimin e Raportit financiar të Komunës së Shtimes për periudhën Janar-Mars 2023.**

Pika 4

Bartja e buxhetit të pa shpenzuar nga viti i kaluar në vitin aktual, dhe rritja e kufirit të hyrave

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Ashtu qysh vendosem në fillim me miratimin e rendit të ditës kjo pikë shkon direkt në Kuvend si rekomandim,

***Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimitisht vendosi që në Kuvend të prezantohet rekomandimi i KPF-së nga mbledhja e kaluar më 28.03.2023 si vijon: KPF, me 3 vota “Për”, me 2 vota “Kundër” dhe me 1 votë “Abstenim” vendosi t’i Rekomandoi Kuvendit, miratimin e vendimit për bartjen e buxhetit të pa shpenzuar nga viti i kaluar në vitin aktual 2023, si dhe rritjen e kufirit të hyrave vetanake, me propozimin që në mbledhjen e Kuvendit më 30.03.2023 të jenë prezent drejtorët dhe të japin sqarime për arsyet, pse i kanë kërkuar mjetet financiare.**

Pika 5

Draft-Strategjia dhe Plani i veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje 2023-2025

(Pas diskutimit publik)

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha z.Reshat Gashit.

z.Reshat Gashi, zyrtar për të drejtat e njeriut dhe barazi gjinore; Përshëndetje, unë nuk kam qka ti shtoj më shumë asaj që është e shkruar, materialin e keni marrë dhe e keni lexuar, prandaj unë ju rekomandoj që ta miratoni. Nëse ka ndonjë pyetje do të përgjigjem.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimitisht vendosi që t’i rekomandoi Kuvendit miratimin e Strategjisë dhe Planin e veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje 2023-2025.**

Pika 6

Draft- Rregullore për punën e Kuvendit dhe Komiteteve

(Pas diskutimit publik)

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; E falenderojë Komisionin për punën. Është mbajtur diskutimi por nuk ka pasë shumë qytetarë, dhe e hapi diskutimin për këtë pikë.

znj.Adelina Beqaj; Unë propozoj që të shkojë direkt në Kuvend. Rekomandoj që të shkojë pa rekomandim në Kuvend.

z.Idajet Rexhepi, Sekretar i Kuvendit; Përshëndetje, Unë ju kisha lut që me shmangë praktikën për mos me qu rekomandim në Kuvend sepse Komitetet janë të formuara pikërisht për këtë qëllim, me dhënë rekomandimet e tyre për me ja lehtësuar punën Kuvendit.

znj.Adelina Beqaj; Unë propozova dhe mua u dasht me mu drejtua. Unë po dua që këto shqetësime me u trajtua në Kuvend, dhe me u votuar. Ne mundemi me vendosë se a me ba rekomandim apo jo.

z.Përparim Ramusa; Te kjo është goxha e rëndësishme që me na dhënë sqarime.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimitisht vendosi që në mbledhjen e Kuvendit më 27.04.2023, Kryetari i Komisionit për hartimin e Draft- Rregullores për punën e Kuvendit dhe Komiteteve, z.Asllan Beqaj të japë sqarime shtesë.**

Pika 7

Draft-Plani Komunal për integritet 2023-2027 (Pas diskutimit publik)

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimitisht vendosi që t’i rekomandoi Kuvendit miratimin e Planit Komunal për integritet 2023-2027.**

Pika 8

Plani Komunal për Ri integrimin e qëndrueshëm të personave te riatdhesuar dhe Integrimin e të huajve, në Komunën e Shtimes 2023-2025

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për këtë pikë. Ne duhet ti rekomandojmë Kuvendit për këtë pikë që të merr vendim që ta nxjerrë diskutim publik.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht vendosi t'i Rekomandoi Kuvendit, miratimin e vendimit për ta nxjerrë në diskutim publik për 15 ditë, Planin Komunal për Ri integrimin e qëndrueshëm të personave te riatdhesuar dhe Integrimin e të huajve, në Komunën e Shtimes 2023-2025. Bartëse e procesit të diskutimit publik është Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim dhe Zyra për Informim.**

Pika 9

Rishqyrtimi i Vendimit Npi-01-81, për Planin komunal për menaxhimin e Mbeturinave 2023-2027, sipas kërkesës të MMPHI-ja Nr.020-282-5-2023

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Dha sqarime se ky vendim është kthyer në rishqyrtim nga MMPHI-ja për arsye se duhet plotësuar baza ligjore.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht vendosi t'i Rekomandoi Kuvendit, miratimin e propozimeve të DSHP-së për sa i përket bazës ligjore të Vendimit Npi-01-81, për Planin komunal për menaxhimin e mbeturinave 2023-2027, sipas kërkesës të MMPHI-ja Nr.020-282-5-2023.**

Pika 10

Propozim-vendim për ndryshimin e destinimit të pronës së paluajtshme komunale në N.K. P-01895-4 ZK-Shtime

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha z.Grejtalb Emini.

z.Grejtalb Emini, drejtor i DPUKGJ; Përshëndetje, kemi disa parcela që janë rrugë por figurojnë si toka bujqësore. Në vazhdim ky e sqaroi këtë pikë me Laptop, sipas hartës në Gjeoportali. Po bëhet fjalë për një rrugë deri te qendra rinore. Kjo pjesë e lidhë rrugën "Skender Salihaj" me rrugën "Mic Sokoli". Kjo ka një sipërfaqe rreth 27.49 m2.

z.Përparim Ramusa; Përshëndetje, unë tash nuk mund të marr vendim pro ose kundër sepse realisht aty është një shtëpi private, edhe do të marr informata shtesë për këtë, e në Kuvend do të vendos për "Pro" ose "Kundër".

z.Lumni Amrush; Tash po e shoh gjendjen, pronari e paska gjysmën e shtëpisë në këtë pronë ku shkruan kullosë. Nuk muj me përkrahë sepse parkingu që është bërë nalt ka mujt të bëhet edhe poshtë. Si drejtor aty kam pas problem. Mendoj se aty ka probleme jo vetëm të Fadilit por ka edhe probleme të tjera. Për sa i përket të mirës së përgjithshme ne aty nuk po bëjmë kurrfar zgjidhje.

z.Përparim Ramusa; Sa katë lejohet ndërtimi i lartë aty, sepse nuk është reviduar plani?

z.Grejtalb Emini, drejtor i DPUKG; Me plan lejohet 8 katë.

z.Kadri Emini; Nëse e ndërrojmë destinimin e kësaj rruge, sado e ngushtë që është, a e rrisin etazhitetin ata banorë aty?

z.Grejtalb Emini, drejtor i DPUKG; Ata kanë me aplikuar për leje ndërtimore, për ndërtimin e lartë, kjo është praktikë edhe te komunat tjera.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Konstatoi Kuorumin prej 6 anëtarëve prezent në mbledhje.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, me 3 vota "Për", me 1 votë "Kundër dhe me 2 vota "Abstenim" vendosi t'i Rekomandoi Kuvendit, miratimin e vendimit për ndryshimin e destinimit të pronës së paluajtshme komunale në Ngastra Kadastrale me numër P-01895-4 ZK-Shtime.**

Pika 11

Propozim -Vendim për pagesën e shpenzimeve të varrimit për qytetarët që varrosen në territorin e Komunës së Shtimes

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; E kemi një propozim prej Ekzekutivit për pagesën prej 250 euro për ç'do qytetarë të varrosur në komunën tonë për shpenzimet e varrimit. Në vazhdim Kryesuesi lexoi propozim – vendimin.

z.Përparim Ramusa; Jemi “pro” se është për interesin e përgjithshëm por të specifikohet, pak më mirë për sa i përket transportit. Nga PDK-ja gjdo iniciativë që merret jemi pro te komuniteti fetar.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Konstatoi Kuorumin prej 6 anëtarëve prezent në mbledhje.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimitisht vendosi t’i Rekomandoi Kuvendit, miratimin e vendimit për caktimin e shumës financiare prej 250 € për pagesën e shpenzimeve të varrimit për qytetarët që varrosen në territorin e Komunës së Shtimes.**

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Pasi diskutime të tjera nuk kishte mbledhja përfundoi në ora 11:23h.

Procesmbajtësi
Idajet Rexhepi



Kryesuesi i KPF
Adnan Ademi